



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Data: 20 Nëntor, viti 2019

NJOFTIM

Shënimi i javës Botërore për përdorimin racional të antibiotikëve, 18-24 Nëntor 2019

Fondi për sigurim shëndetësor në mënyrë aktive e përkrah duke marrë pjesë në fushatën kombëtare të ndërgjegjësimit publik për përdorimin e drejtë të antibiotikëve, në kuadër të shënimit të javës Botërore për përdorimin racional të antibiotikëve dhe ditës Evropiane për përdorimin racional të antibiotikëve me qëllim që të ruajë rëndësinë dhe vlerën e tyre të veçantë terapeutike si barna që shpëtojnë jetë.

Konsumimi i përgjithshëm i antibiotikëve në vend, në vitin 2018 vlerësohet në rangun prej 30 deri 35 DPD (doza të përcaktuara ditore) në 1000 banor për ditë, e krahasuar me mesataren evropiane që është 20,1 DPD në 1000 shfrytëzues në ditë, dhe kjo statistikë qartë tregon se është e nevojshme një luftë serioze me rezistencën antimikrobiake që arrihet përmes përdorimit racional të antibiotikëve. Shpenzimet për antibiotikët nga ana e Fondit për vitin 2018 në kujdesin shëndetësor primar ka arritur diku deri 17 DPD (doza të përcaktuara ditore) të 1000 personave të siguruar për një ditë, duke marrë parasysh grupet e reja ATC dhe indeksin DPD për barnat e caktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë - OBSH . Fondi i ka vetëm të dhëna për konsumin e antibiotikëve me receta të cilat janë në listën pozitive. Por numri i konsumit të antibiotikëve është më i madh për arsye se ka të evidentuara antibiotikë që shiten por nuk janë në listën pozitive dhe për këtë Fondi nuk posedon të dhëna.

Nga analizat e rregullta të Fondit për sigurim shëndetësor për vitin 2018 , vërehet se janë realizuar 1,75 milion receta për antibiotikë ose 295 milion denarë. Numri i recetave për antibiotikë në krahasim me vitin 2017 ka rënë për 2% por kjo akoma është shqetësuese nga fakti se kemi rritje për 14% të numrit të recetave për antibiotikë nga nëngrupa Makrolidi, për 2% është rritur numri i recetave të antibiotikëve Betalaktamski-penicilin si dhe rritje për 2% të antibiotikëve Cefalosporin nga gjenerata e dytë. Antibiotiku më i përdorur në kujdesin shëndetësor primar është Amoxicillin+clavulanic acid, ndërsa në kujdesin shëndetësor spitalor është Ceftriaxon. Kjo do të thotë se dhënia e antibiotikëve me receta me një gamë më të gjërë veprimesh, rritet rreziku nga shtimi i llojeve rezistente të bakterieve.

Për këtë arsye Fondi apelon që të zbatohet në mënyrë racionale përdorimi i barnave, bazuar në fakte mjekësore dhe në të njejtën kohë duke ngritur vetëdijen edhe te personat e siguruar që t'i respektojnë këshillat e mjekëve dhe farmacistëve në lidhje me shfrytëzimin e antibiotikëve.